



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/Nr. 18 Tiranë,

Tel/Fax 04 2226814 ; 04 2226814

Nr. 385/8 Prot.

Tiranë, më 04.07.2016

V E N D I M

Nr. 77, datë 04.07.2016

***“Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 385/1 prot, datë 30.05.2016”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në institucionin e Ministrisë së Financave dhe DAP, për rastin e nëpunëses *****,

VËREJ SE,

Me Urdhrin nr. 385/1 prot, datë 30.05.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka nisur verifikimi i ligjshmërisë së aktit administrativ nr.1567/14, datë 28.04.2016, të Departamentit të Administratës Publike “Për transferimin për shkak të ristrukturimit”, të nëpunëses *****, nga pozicioni i punës “Drejtor Drejtorie në Drejtorinë e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit”, në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori në Sektorin Help Desk”, në Ministrinë e Financave.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 385/3, datë 30.05.2016 dhe shkresës nr. 385/4, datë 30.05.2016, u vunë në dijeni Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike, për fillimin e këtij verifikimi, si dhe u kërkua nga institucionet, dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e tij.

Nga përmbajtja e përgjigjeve të dhëna me shkresat nr. 2777/1, datë 06.06.2016, “Kthim përgjigje”, të Departamentit të Administratës Publike dhe nr. 7742/2, datë 08.06.2016, “Kthim përgjigje”, të Ministrisë së Financave, drejtuar Komisionerit, rezultoi se, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, mbi bazën e padisë së ngritur prej nëpunëses ***** , ka filluar shqyrtimin e çështjes gjyqësore, duke vendosur si seancë përgatitore, datën 15.06.2016.

Konstatohet se, kjo nëpunëse paraqitet si palë paditëse në këtë proces gjyqësor, kundër palës së paditur, Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, me objekt gjykimi:

“Shfuqizimin e Vendimit nr.1567/14, datë 28.04.2016, të Departamentit të Administratës Publike “Për transferimin për shkak të ristrukturimit”, të paditëses, nga pozicioni i punës “Drejtor Drejtorie në Drejtorinë e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit”, në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori në Sektorin Help Desk”, në Ministrinë e Financave, etj.

Sa më sipër, vërtetohet nga aktet bashkëlidhur këtyre shkresave si, kërkesë-padia dhe aktet shoqëruese, njoftimi i gjykatës për seancën përgatitore, të cilat janë dërguar nga institucionet së bashku me informacionin e kërkuar në këtë rast.

Në këto kushte, bazuar në parimin e sanksionuar në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se, institucionet e tjera nuk mund të shqyrtojnë çështje që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësohet se në këtë rast, nuk është e nevojshme ndërhyrja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 385/1 prot, datë 30.05.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Për verifikimin e ligjshmërisë të aktit administrativ”, nr.1567/14, datë 28.04.2016, të Departamentit të Administratës Publike “Për transferimin për shkak të ristrukturimit”, të nëpunëses *****, nga pozicioni i punës “Drejtor Drejtorie në Drejtorinë e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit”, në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori në Sektorin Help Desk”, në Ministrinë e Financave.
2. Të njoftohen për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Financave, si dhe kërkuësja, *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA